REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës:	2021:101107
Datë:	11.10.2021
Numri i dokumentit:	02328523

K.nr.1308/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në përbërje të gjyqtarit individual Bahri Salihu me pjesëmarrjen e sekretares juridike Igballe Arifi, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **E.M.** nga fshati ..., Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 231 par.5 të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088) dhe nenit 19 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LRRTRR (Ligji nr.06/L-069), në bazë të neneve 27.1, 55.2,77,86,119,124 dhe 127 të Ligjit për Kundërvajtje nr. 05/L-087, më datë 11.10.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **E.(Q.)M.,** me nr. personal ..., i lindur më dt...., në fshatin ..., Komuna e Ferizajt, me vendbanim në te njëjtin vend, shtetas i Republikës së Kosovës,

2021:101108

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse më datë 18.05.2021, rreth orës 13:25, në fshatin Slivovë, Komuna e Ferizajt, gjer sa ishte duke drejtuar automjetin transportues të markës "Opel Combo", me targa të regjistrimit ..., është ndaluar nga njësiti i trafikut rrugor të Stacionit Policor të Ferizajt, me ç'rast pas kontrollës-kërkimit të dokumentacionit, ka rezultuar se i njëjti ka drejtuar automjetin e lartpërmendur pa poseduar patentë shoferi, përkatësisht pa e fituar të drejtën për drejtimin e automjetit

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 231 par. 5 të LRRTRR-së (Ligji nr. 05/L-088) dhe nenit 19 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor (Ligji nr.06/L-069)

- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore, në mbështetje të nenit 48 par. 2 të Ligjit për Kundërvajtje

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 500 € (Pesëqind euro)

Dënimin e shqiptuar në të holla ka për t'a paguar në afat prej 90 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me mundësi të pagesës në tri këste mujore, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore. I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale (paushallit gjyqësor) të paguaj shumën prej 10,oo.- € (dhjetë euro) në afatin e njëjtë sikurse denimin në të holla në kuptim të nenit 59 dhe 76 të Ligjit për Kundërvajtje.

Nga një ekzemplar i këtij aktgjykimi iu dërgohet palëve.

A r s y e t i m i

Drejtoria Rajonale e Policisë-NJRKRR në Ferizaj, kësaj gjykate i ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse **nr. SHQ5A0001756783N, date 19.05.2021,** kundër të pandehurit të lartëshenuar për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 231. par.5 të

2021:101108

LRRTRR, me të cilën ka kërkuar që pranë kësaj gjykate të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe pas administrimit të provave të propozuara, i njejti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse, ftoi të pandehurin në mënyrë të rregullt për paraqitjen e mbrojtjes së tij, për datë 07.10.2021, por i njëjti thirrjes nuk i është përgjigjur, kurse mungesën me asgjë nuk e ka arsyetuar. Marrja e tij në pyetje për konstatimin e fakteve të kundërvajtjes nuk ishte e domosdoshme, pasi që nga kërkesa e stacionit policor si dhe fletëparaqitja për kundërvajtje në trafik, vepra kundërvajtës e cila i është ngarkuar të pandehurit është kjartësuar mjaft, prandaj u plotësuan kushtet për marrjen e vendimit të ligjshëm në bazë të nenit 48 par.2 të Ligjit për Kundërvajtje.

Pas shqyrtimit të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse , të parapara sipas dispozitave të nenit 231 par. 5 të LRTRR, dhe nenit 19 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, gjyqtari maur parasysh rrethanat e parapara me nenin 31 të Ligjit për Kundërvajtje dhe atë peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, shkallën e përgjegjësisë, ndërkaq rrethana lehtësuese e po ashtu edhe rënduese nuk u gjetën në rastin konkret me që i pandehuri nuk i është përgjigjur ftesës së gjykatës, andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES
Datë, 11.10.2021

G j y q t a r i

Bahri Salihu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 (tetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Divizionit të kundërvajtjes, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

2021:101108